



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 36, datë 31.07.2024

P Ë R

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“GREEN COAST RESORT 2, ZONA E, OBJEKTE REZIDENCIALE- VILA 1 DHE 2
KATE, ME PISHINË DHE MUR RRETHUES”, ME VENDNDODHJE NË PALASË,
BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive “Green Coast” sh.p.k si dhe “Seaside Residence II” sh.p.k , Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Green Coast Resort 2, Zona E, objekte rezidenciale - vila 1 dhe 2 kate, me pishinë dhe mur rrethues”, me vendndodhje në Palasë, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Green Coast” sh.p.k si dhe “Seaside Residence II” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI


LEDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR/SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshtkruar më datë 27 / 03 / 2025